

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit B.A., nga fshati P., komuna e P., për shkak të veprës penale vjedhje pylli në vazhdimësi nga neni 358 par.2 e lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga i dënuari kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë - Dega në Podujeve, P.nr.1785/2012 datë 19.9.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr.1159/2017 datë 22.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit B.A., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë - Dega në Podujeve, P.nr.1785/2012 datë 19.9.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1159/2017 datë 22.12.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë - Dega në Podujevë, P.nr.1785/2012 datë 19.9.2017, i dënuari B.A., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje pylli në vazhdim nga neni 358 par.2 e lidhur me par.1 të KPK dhe për këtë vepër është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajsh dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 €, të cilin dënim është i detyruar që të paguajë në këste mujore në afat prej 3 muaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mos pagesës e njëjta do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur çdo 20 € me një ditë burgim. Është detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 €, të gjitha në

afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa e dëmtuara për realizmin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.1159/2017 datë 22.12.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza ose t'i shqiptohet një dënim më i butë. Njëherësh është propozuar që të shtyhet ekzekutimi i vendimit të plotfuqishëm.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.20/2018 datë 12.2.2018, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, i dënuari potencon se aktgjykimet e kundërshtuara bazohen vetëm në një provë respektivisht në deklaratën e rojtarit të pyllit dhe nuk ka ndonjë provë tjetër as ndonjë ekspertizë lidhur me sasinë dhe llojin e drunjtëve të prera, kështu që aktgjykimet janë të kundërligjshme.

Në pjesën tjetër të kërkesës i dënuari i referohet dënimit të shqiptuar duke theksuar se dënimi është shumë i rëndë, të njëjtin nuk mund ta përballojë sepse është i gjendjes së rëndë ekonomike-sociale dhe është mbajtës i familjes. Më pas thekson se meqë gjykata e shkallës së dytë nuk ka evituar shkeljet në fjalë edhe aktgjykimi i shkallës së dytë është i kundërligjshëm.

Gjykata Supreme, vlerëson si të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga këto arsye:

Fillimisht duhet theksuar se në rastin konkret, aktgjykimi i shkallës së parë është marrë mbi bazën e pranimit të fajësisë e që rezulton nga procesverbali mbi shqyrtimin fillestar të datës 12.9.2017 ku i dënuari është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar. Nga i njëjti procesverbal rezulton se në seancë ka qenë prezent edhe mbrojtësi i tij avokati M.H., i cili ka qenë prezent dhe ka marrë pjesë aktive lidhur me deklarinimin e të dënuarit rreth fajësisë, të cilët në

asnjë moment nuk i kanë kundërshtuar provat apo cilësimin juridik të veprës penale. Gjykata e shkallës së parë duke gjetur se janë përmbushur kërkesat e nenit 248 të KPPK, ka marrë vendim për pranimin e fajësisë dhe të dënuarit i ka shqiptuar dënimin.

Nuk është i bazuar pretendimi se aktgjykimi i shkallës së parë bazohet vetëm në një provë, përkundrazi dëshmia e dëshmitarit – rojës së pyllit T.S., nuk ka qenë provë e vetme dhe e izoluar në këtë çështje por aktakuza mbështetet edhe në shkresën-fletëparaqitjen e datës 26.6.2012 të cilat prova i dënuari dhe mbrojtësi i tij nuk i kanë kundërshtuar.

Pjesa tjetër e kërkesës, i referohet shkeljes së ligjit penal respektivisht vendimit për dënimin, me pretendim se dënimi i shqiptuar është i rëndë duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, të cilat janë specifikuar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se konform dispozitës së nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënimin, dënimin alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm, për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me dënimin, përmes individualizimit të dënimit i ka shqiptuar dënimin brenda kufijve të paraparë për këtë vepër penale.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërli dhej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 347 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.29/2018, më 30 prill 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta